



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:096659

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453313

C.nr.291/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike të paditëseve: A.L nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit dhe L.U nga Gjakova, të cilat i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.B.O nga Rahoveci, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 1,314.60 Euro, jashtë shqyrtimit, me datë **14.03.2024** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: A.L nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit dhe L.U nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëseve në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në punë, t'ua paguaj shumat si në vijim:

Paditëses A.L në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën prej datës 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022, t'ia paguaj shumën prej 885.50 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë cent) Euro, në të cilën përfshihet 70% e biletës së udhëtimit, në shumën prej 5.00 euro, për 253 ditë të vajtjes në punë, në relacionin Hoçë e Vogël - Radostë dhe anasjelltas.

Paditëses L.U në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën prej datës 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022, t'ia paguaj shumën prej 878.50 (tetëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë cent) Euro, në të cilën përfshihet 70% e biletës së udhëtimit, në shumën prej 5.00 euro, për 251 ditë të vajtjes në punë, në relacionin Gjakovë - Radostë dhe anasjelltas, për të dy paditëset shumën e përgjithshme prej 1,314.60 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë (datë 25.04.2023), e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve t'ia paguajë shumën prej 187.00 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) Euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset: A.L nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit dhe L.U nga Gjakova, të cilat i përfaqëson av. D.M nga Prizreni, në këtë gjykatë, me datë 25.04.2023 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre Av. D.M në padi kanë theksuar se janë të punësuar në pozitën mësimdhënëse në SHFMU “Skender Kastrati” në Radostë dhe vazhdojnë të punojnë në këtë institucion, e që duke llogaritur periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datë 21.11.2022 paditësve i ka takuar e drejta e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për në punë dhe atë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit prej datës 21.01.2021, por që deri tani nuk janë kompensuar, andaj sipas kushteve të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të datës 21.01.2021, përkatësisht dispozitat ligjore të nenit 35, i cili përcakton kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për në punë si dhe duke u bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05-L031, përkatësisht nenin 98 par.2, paditëset i janë drejtuar gjykatës me padi me qëllim të realizimit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas të cilës kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën prej datës 21.01.2021 e deri më datë 21.11.2022 ashtu që: paditësja A.L ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për relacionin nga fshati Hoçë e Vogël e deri në vendpunim në Radostë, duke llogaritur 70% të biletës prej 5.00 Euro, për 253 ditë të vajtjes në punë, e që shuma e përgjithshme është vlera prej 885.50 Euro dhe paditësja L.U ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në relacionin nga Gjakova e deri në vendpunim në Radostë, duke llogaritur 70% të biletës prej 5.00 Euro, për 251 ditë të vajtjes në punë, e që shuma e përgjithshme është vlera prej 878.50 Euro, si dhe shuma e përgjithshme për të dy paditëset është shuma në vlerë prej 1,314.60 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar në shumën prej 187.00 Euro.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtori Komunale për Arsim, përmes të autorizuarit të saj Av.B.Onë përgjigjje ka theksuar: tërësi e kontestoj kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar dhe të pa themeltë, duke shtuar se MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. MASHT-i me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshëm bazuar në kornizat ligjore në fuqi, pasi që e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore, në shpërputhje me dispozitat e rendit publik dhe mungesës së legjitimitetit të palës nënshkruese. Në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë të rregullt administrative pranë të paditurës respektivisht paditësit nuk kanë parashtruar ndonjë ankesë apo kërkesë pranë punëdhënësit. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerr të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si punëdhënësi, konform Ligjit të Punës Nr.03/ L-212, neni 78 par.1,2,3. E kontestojmë në tërësi kërkesën respektivisht vërtetimet e Shoqatës së Transportit në Prizren të cilat nuk janë kompetente për caktimin e çmimeve të udhëtimit. Çmimet e transportit të udhëtarëve i caktojnë kompanitë të regjistruara/licencuara që kryejnë transportin e udhëtarëve mbi parimin e tregut të lirë. E paditura konsideron se kërkesa e paditësve është në kundërshtim me KKAK të datës 17.04.2017 dhe KKAK të datës 21.01.2021, ku është përcaktuar se “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave e trafikut urban*”. Pra dispozita ka përcaktuar se shpenzimet e udhëtimit paguhen vetëm për ata punëtorë të arsimit që udhëtojnë në vendbanimet e komunës për biletat e trafikut urban, ndërsa këtu kemi kërkesën për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për vendbanimin jashtë komunës dhe atë për trafikun jo urban. Lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur i

referohemi nenit 124 par.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit përcaktohet shprehimisht detyrimi i Ministrisë Përkatëse “*Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit*”. Padia e paditësve nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjedhimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara në padi, paditësit nuk kanë arritur të argumentojnë themelësinë e kërkesëpadisë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – DKA andaj i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë, si në petitum të padisë. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në shumën prej 156.00 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënëse tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Skender Kastrati” në Radostë. Kjo vërtetohet edhe nga Kontratat e punës dhe Vërtetimet për përvojën e punës në emër të paditësve të lëshuara nga e paditura me datë 04.04.2023.

Nga vërtetimet mbi ditët e prezencës në punë: nr. 02/612/2023, të datës 04.04.2023 dhe nr. 02/617/2023 të datës 04.04.2023, të lëshuara nga SHFMU “Skender Kastrati” në Radostë, si dhe me shikimin e Kontratave të punës: nr.prot 500, të datës 01.09.2021 dhe nr.prot 01-, të datës 01.09.2015, të cilave gjykata ua dha besimin e plotë, vërtetoi faktin se paditëset kanë themeluar marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënëse në SHFMU “Skender Kastrati” në Radostë dhe për periudhën nga data 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022 paditësja A.L ka gjithsej 253 ditë pune dhe paditësja L.Uka gjithsej 251 ditë pune.

Me shikimin dhe analizimin e Certifikatës së vendbanimit nr.ser. B10441308, të lëshuar me datë 02.03.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile në Hoçë të Vogël dhe vërtetimit të biletave të udhëtimit të muajit Shkurt 2023, të lëshuar nga Shoqata e Transportit “KOSOVA E LIRË” (të cilëve gjykata ua dha besimin e plotë), vërtetohet fakti se paditësja A.L ka vendbanimin në fshatin Hoçë e Vogël dhe për të shkuar në vendin e punës, duhet të udhëtojë në relacionin Hoçë e Vogël – Radostë dhe anasjelltas, si dhe të paguajë biletën e udhëtimit në shumë prej 2,50 euro në një drejtim, e në shumë prej 5.00 euro në të dyja drejtimet.

Me shikimin dhe analizimin e Certifikatës së vendbanimit nr.ser. B10439890, të lëshuar me datë 24.02.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile në Gërgoc - Gjakovë dhe vërtetimit të biletave të udhëtimit të muajit Shkurt 2023, të lëshuar nga Shoqata e Transportit “KOSOVA E LIRË” (të cilëve gjykata ua dha besimin e plotë), vërtetohet fakti se paditësja L.U ka vendbanimin në Gjakovë dhe për të shkuar në vendin e punës, duhet të udhëtojë në relacionin Gjakovë – Radostë dhe anasjelltas, si dhe të paguajë biletën e udhëtimit në shumë prej 2,50 euro në një drejtim, e në shumë prej 5.00 euro në të dyja drejtimet.

Ligji Nr.03/L-212 i Punës, neni 90 par. 4 dhe 5 përcaktojnë se: “4. *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.*” dhe “5.

Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.”

Neni 35 par. 5 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01/B-105 të datës 22.01.2021, përcakton që: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.”*

Pra, në pajtueshmëri me dispozitën ligjore të lartcekur është paraparë detyrimi i punëdhënësit, në rastin konkret të paditurës, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, për shkak se Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret, e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim.

Andaj, gjykata e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses A.L për periudhën prej datës 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t’ia paguaj shumën prej 885.50 Euro, (253 ditë pune x 5.00 euro biletë x 70% = 885.50 Euro) dhe paditëses L.U për periudhën prej datës 21.01.2021 e deri me datë 21.11.2022, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t’ia paguaj shumën prej 878.50 Euro, (251 ditë pune x 5.00 euro biletë x 70% = 878.50 Euro).

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësve ishte qartazi e themeltë, si e tillë ka bazë në dispozitat e Kontratës Kolektive të përmendur më lartë, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje në padi gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadija e paditësve. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë janë të pabazuara, me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve (mësimdhënësve) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk kanë mbështetje ligjore, për faktin se Kontrata Kolektive Nr.01/B-105 e datës 22.01.2021, është në fuqi nga data 22.01.2021 e deri me datë 21.11.2022, pra brenda periudhës kohore si në kërkesëpadi dhe si e tillë prodhon efekt juridik lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, këtu palëve ndërgjyqëse.

Gjykata ka vendosur për kamatën ligjore prej 8%, konform nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditëseve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 187.00 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 156.00 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 31.00 Euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC

C.nr.291/2023, datë 14.03.2024

G j y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.